


Më shumë se 11,000 anketues do të trokasin në dyert tona, rreth një milion familje do të plotësojnë së bashku me ta pyetësorët. Regjistrimi nuk është i rëndësishëm vetëm për nga madhësia e tij, por edhe nga ato që ne do të mësojmë për:

- sa jemi, ç'moshë kemi dhe ku jemi?
- sa dhe si janë fëmijët tanë?
- sa punojmë dhe me çfarë aktivitetelesh merremi?
- sa vite shkollë kemi kryer dhe çfarë profesioneesh kemi?
- si shkojmë në punë dhe sa kohë na duhet?
- si janë ndërtuar shtëpitë tona dhe kur?
- çfarë nevojash kemi për shërbimet publike?
- sa të pranishme janë në banesat tona pajisjet elektroshtëpiake?



design: Picto Multimedia • www.picto.it



www.repoba.al

Një gjest i vogël, një investim i madh.

INSTAT-i është Instituti i Statistikës, institucioni që kryen shërbimin statistikor në Shqipëri. Të dhënat që njofton e publikon Instituti i Statistikës përfaqësojnë të dhënat zyrtare të vendit. INSTAT-i është krijuar në Prill të vitit 1993, dhe i shërben të gjithë Shoqërisë dhe vendit. Ai organizon dhe drejton kryerjen e regjistrimeve të përgjithshme, si: regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave, regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore, atë të industrisë etj.

 **INSTAT**
INSTITUTI I STATISTIKËS

Rr. "Lekë Dukagjini" nr. 5, Tiranë
Tel. 04 230 484 / 222 411 - Fax 04 228 300
www.instat.gov.al

Regjistrimi i përgjithshëm
i popullsisë dhe banesave,
Prill 2001,
është përpjekja më
e madhe gjithëpërfshirëse
që bëjmë sot, në Shqipëri.

INSTITUTI I STATISTIKËS
REGJISTRIMI I POPULLSISË E BANESAVE 2001



Një gjest i vogël, një investim i madh.



Në Shqipëri këto vitet e fundit kanë ndodhur ndryshime të mëdha demografike. Lëvizja e lirë e shtetasve ka sjellë ndryshime në strukturën e popullsisë dhe numrin e familjeve të zonave të ndryshme gjeografike. Po ashtu, kanë ndryshuar ndjeshëm zakonet dhe nevojat e përditshme të të gjithë shqiptarëve. Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë është baza për krijimin e një kujtese kolektive që dokumenton evolucionin territorial, social, dhe ekonomik të Shqipërisë.

Si realizohet regjistrimi?

Regjistrimi është i saktë në qoftë se ju, që merrni pjesë në të, jeni të qartë. Për të plotësuar një pyetësor, duhet t'u përgjigjemi të gjitha pyetjeve që do të bëjë anketuesi, i cili do të trokasë në derën tuaj gjatë muajit Prill dhe do të paraqitet përpara jush me një kartë identifikimi.

Anketuesi e di që përgjigjet tuaja janë shumë të rëndësishme. Ai ka marrë pjesë në kualifikimet që ka organizuar INSTAT dhe di ta

plotësojë mirë pyetësorin. Është shumë e lehtë që të marrësh pjesë në regjistrim, përgjigjet tuaja janë të asistuara nga anketuesi. Çdo anketues është i detyruar të ruajë sekretin e informacionit. Këtë detyrë e ka gjithashtu edhe i gjithë personeli i Regjistrimit.



Ruajtja e së fshehtës personale

Ruajtja e së fshehtës personale është e garantuar me ligj, çdo person u përgjigjet të njëjtave pyetje. Përgjigjet janë private dhe janë në dispozicion vetëm të INSTAT-it.

Karakteristikat identifikuese, si: emri, mbiemri janë të përkohëshme. Ato, pas kontrolleve teknike për saktësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre, bëhen anonime. Do të ruhen vetëm ato të dhëna të cilat nuk kanë për qëllim dhënien e informacionit në nivel individual, por të dhëna strukturore për grupet e personave me karakteristika të ngjashme. Kush thyen këtë ligj dënohet dhe kjo shkelje mbetet e dënueshme edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës me programin e regjistrimit.

Përgjigjet tuaja do të përdoren për JU

Rezultatet e regjistrimit përdoren nga:

- Qeveria, për hartimin e politikave të zhvillimit të vendit, siç janë: akordimi i fondeve për shërbimet publike: transportin publik, ndërtimin e shkollave të reja, parqeve, vendeve të argëtimit për fëmijë, ndërtesave publike, rrugëve të reja dhe shumë projekteve të tjera.
- Organizatrat e ndryshme përdorin rezultatet e regjistrimit për zhvillimin e programeve për shërbimet sociale dhe për qendrat e kujdesit të fëmijëve.
- Bizneset i përdorin të dhënat për të kuptuar sesi duhet të shpërndajnë, kapitalet, pikat e shitjes, kinematë, teatrot, bankat, dhe zyrat për të krijuar vendet e reja të punës.

